**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-26-8424-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me materiale shpenzuese për elektrostimulim për nevojat e Kardiologjisë**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **AGS Corporation SH.P.K.** |
| NUI | **811859240** |
| Adresa | **Dardania BL.1 Hy.3** |
| Vendi | **PRISHTINË** |
| Kodi postar | **10000** |
| Numri Telefonit | |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Gazmend Boshnjaku** |
| Adresa elektronike | **gazmendb@agskosovo.com** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **02.11.2026** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

| | |
|---|---|
| Emri i avokatit | **Shkumbin Asllani** |
| Adresa e plotë | **Rr.Mark Isaku L1/A5 Prishtine** |
| Numri i Telefonit | **+38344366007** |
| Numri i faks-it | |

Adresa elektronike **shkumbin.asllani@inlexpartners.com**

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Lot 9 PACEMAKER (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)[]Lot 10 PACEMAKER (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)[]Lot 11 BIVENTRICULAR PACEMAKER (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)[]Lot 12 INTRACARDIAC DEFIBRILATOR (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)[]Lot 13 INTRACARDIAC DEFIBRILATOR (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)[]Lot 14 INTRACARDIAC DEFIBRILATOR + CRT (përfshi edhe letër përkatëse të printerit për programatorin përaktës, sipas prodhuesit)**

1. **Kërkesa për rishqyrtim në procedurën e mëparshme, me numër prokurimi 220-26-5932-1-1-1, është paraqitur më 12 gusht 2026;**

2. **Vendimi për aprovimin e pjesshëm të kërkesës dhe anulimin e procedurës së mëparshme është nxjerrë më 17 gusht 2026;**

3. **Dosja e Tenderit për procedurën e rishpallur, me numër prokurimi 220-26-8424-1-1-1, mban datën 1 tetor 2026;**

4. **Njoftimi për Kontratë është publikuar më 2 tetor 2026;**

5. **Dosja e korrigjuar e Tenderit dhe informatat sqaruese për Lotet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 mbajnë datën 21 tetor 2026;**

6. **Formulari B54 për korrigjimin e gabimeve në njoftim është publikuar më 22 tetor 2026;**

7. **Kërkesa për Rishqyrtim e AGS Corporation Sh.P.K. është paraqitur më 27 tetor 2026;**

8. **Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim është nxjerrë më 30 tetor 2026.**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☐ ***Jo*** ☒

***6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve***

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Kërkesa për Rishqyrtim e AGS Corporation Sh.P.K. është paraqitur më 27 tetor 2026;**

**Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim është nxjerrë më 30 tetor 2026.**

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Me veprimet dhe mosveprimet e tij, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenet 1, 7 dhe 28, si dhe me Nenin 108/A, paragrafët 9 dhe 12, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, siç është ndryshuar dhe plotësuar ("**LPP**"), dhe me Nenin 62.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, siç është ndryshuar dhe plotësuar ("**Rregullorja për Prokurimin Publik**").
Vendimi i Kontestuar bie ndesh edhe me standardin e arsyetimit të përcaktuar në Nenin 48, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("**LPPA**").
Ndërsa kërkesa për korrigjimin e dokumentacionit të tenderit dhe përshtatjen e afatit të ofertimit mbështetet në Nenin 63.1.3, pika b, të Rregullores për Prokurimin Publik dhe në Nenin 53 të LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**FAKTET E RASTIT** Më 12 gusht 2026, në kuadër të aktivitetit të mëparshëm të prokurimit "Furnizim me materiale shpenzuese për elektrostimulim për nevojat e Kardiologjisë",

me numër prokurimi 220-26-5932-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-26-058-1-1-1, Ankuesi kishte paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim. Përmes saj kishte kundërshtuar, ndër të tjera,

specifikimet teknike si kufizuese dhe diskriminuese dhe kishte kërkuar riformulimin e tyre, duke mundësuar ofertimin me produkte që përmbushin në mënyrë ekuivalente kërkesat

teknike, funksionale dhe të sigurisë.

Më 17 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues e kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim. Në përgjigjen përfundimtare të përfshirë në vendim, kishte deklaruar se njësia kërkuese

e kishte konsideruar kërkesën pjesërisht të bazuar dhe se ishte vlerësuar i arsyeshëm rifillimi i procedurës. Në të njëjtën pjesë ishte përcaktuar shprehimisht se aktiviteti do të anulohej dhe

do të rishpallej.

**Provë**: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 17 gusht 2026

Më 2 tetor 2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për

aktivitetin e rishpallur me të njëjtin objekt, me numër prokurimi 220-26-8424-1-1-1 dhe numër të

brendshëm 220-26-088-1-1-1, ndërsa Dosja e Tenderit mban datën 1 tetor 2026. Pavarësisht anulimit të procedurës së mëparshme, në aktivitetin e rishpallur janë përsëritur të njëjtat

specifikime teknike të kontestuara më parë për Lotet 9–14.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, Ankuesi ka paraqitur kërkesë për sqarimin dhe përshtatjen e specifikimeve teknike për Lotet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Në këtë kërkesë ka evidentuar përsëritjen e specifikimeve nga procedura e anuluar dhe ka kërkuar heqjen e kritereve që, sipas vlerësimit të tij, kufizonin konkurrencën në

karakteristika të një prodhuesi të vetëm Medtronic. Ndryshimet e kërkuara për secilin lot kanë qenë si në vijim:

Për Lotin 9 – Pacemaker Single Chamber, është kërkuar heqja e kriterit për programimin e pavarur të përshtatjes së frekuencës për zonën e aktivitetit fizik normal dhe atë të

aktivitetit fizik të lartë, të përcaktuar si: “Independent programming of frequency adaptability for the zone of normal and for the zone of high physical load”.

Për Lotin 10 – Pacemaker Dual Chamber, është kërkuar gjithashtu heqja e kriterit për programimin e pavarur të përshtatjes së frekuencës për zonën e aktivitetit fizik normal dhe atë t

ë aktivitetit fizik të lartë.

Për Lotin 11 – Biventricular Pacemaker, është kërkuar heqja e kriterit për alarmin zanor ose vibrues për pacientin, të përcaktuar si: “Auditory or vibratory alarm for the patient”.

Për Lotin 12 – Intracardiac Defibrilator, është kërkuar heqja e katër kritereve: “Discrimination in VF Zone”; alarmi zanor ose vibrues për pacientin; mundësia e programimit.

të dy opsioneve të terapisë ATP në zonën VF, përkatësisht ATP para dhe gjatë ngarkimit; si dhe kërkesa “Possibility to program at least two options for sensing and pacing leads”.

Për Lotin 13 – Intracardiac Defibrilator, është kërkuar heqja e kriterit për alarmin zanor ose vibrues për pacientin dhe e kërkesës për programimin e të dy

opsioneve të terapisë ATP në zonën VF, përkatësisht ATP para dhe gjatë ngarkimit.

Për Lotin 14 – Intracardiac Defibrilator CRT, është kërkuar gjithashtu heqja e kërkesës për programimin e të dy opsioneve të terapisë ATP në zonën VF, përkatësisht ATP para

dhe gjatë ngarkimit, si dhe e kriterit për alarmin zanor ose vibrues për pacientin.

**Provë**: Kërkesa për sqarime, e riprodhuar në dokumentin “Përgjigje në kërkesën për sqarim të DT”, të datës 21 tetor 2026, faqet 1–2

Më 21 tetor 2026, Autoriteti Kontraktues ka dhënë përgjigje përmes njësisë kërkuese, duke deklaruar se karakteristikat e trajtuara për të gjashtë lotet ishin klinikisht të

arsyeshme dhe të dobishmedhe se ato i posedonin disa prej prodhuesve më të mëdhenj botërorë. Për kërkesën e Lotit 12, “Possibility to program at least two options for sensing

and pacing leads”, ka sqaruar shprehimisht se mund të konsideroheshin edhe variante klinikisht ekuivalente me këtë funksion. Dokumentacioni i korrigjuar mban po ashtu datën

21 tetor 2026, ndërsa Formulari B54 është publikuar më 22 tetor 2026.

Më 27 tetor 2026, Ankuesi ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim dhe Përshtatje të Specifikimeve Teknike për Lotet 9–14, duke

kundërshtuar përsëri kufizimin e konkurrencës dhe duke kërkuar pranimin e produkteve ekuivalente ose teknologjikisht më të avancuara.

Konkretisht, Ankuesi ka kërkuar që t’i lejohet që përputhshmëria e produkteve të dëshmohet përmes dokumentacionit zyrtar të prodhuesit, certifikimeve përkatëse

dhe evidencës së përputhshmërisë klinike dhe funksionale. Përmes tabelës së bashkëngjitur Kërkesës për Rishqyrtim, Ankuesi ka konkretizuar përshtatjen e kërkuar të specifikimeve teknike.

**Provë**: Kërkesa për Rishqyrtim e datës 27 tetor 2026

Më 30 tetor 2026, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim si të pabazuar.

Në këtë vendim është riprodhuar kërkesa e Ankuesit, përfshirë tabelën me parametrat teknikë të propozuar për të gjashtë lotet.

Ndërsa në përgjigjen e njësisë kërkuese, të përfshirë në faqen 7 të të njëjtit vendim, janë përmendur shprehimisht

Lotet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14, ndërsa "karakteristikat e lartpërmendura" janë vlerësuar si klinikisht të arsyeshme dhe të dobishme

1.1. Më tej, është deklaruar se ofrimi i produkteve teknologjikisht më të avancuara, me karakteristika të njëjta ose superiore, është i mundshëm dhe i dobishëm, me kusht që produktet të posedojnë certifikatat e sigurisë dhe standardet e nevojshme dhe të jenë në përputhje me infrastrukturën e disponueshme në shërbim.

1.1. Pavarësisht këtij vlerësimi pozitiv, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar, pa shpjeguar pse qëndrimi i njësisë kërkuese nuk ka rezultuar

në pranimin e kërkesës për përshtatjen e specifikimeve. Për më tepër, Vendimi nuk e sqaron nëse karakteristikat e propozuara për të gjashtë lotet do të pranohen gjatë vlerësimit të ofertave.

**Provë**: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 30 tetor 2026

1.1. Theksojmë se produktet që synojmë të ofertojmë përfaqësojnë teknologjinë më të fundit të **BIOTRONIK**, njërit prej prodhuesve më të mëdhenj gjermanë dhe botërorë në

fushën e pajisjeve kardiake elektrostimuluese. Si dëshmi që kundërshton arsyetimin e Departamentit se ka përvojë klinike vetem me produktet Medtronic, rikujtojmë se

**BIOTRONIK ka furnizuar vazhdimisht QKUK-në gjatë 15 viteve të fundit**, ndërsa pajisjet e programimit dhe kontrollit të këtij prodhuesi gjenden edhe në sallat

operative të vetë Departamentit. Rrjedhimisht, Departamenti e njeh shumë mirë këtë prodhues dhe ka përvojë të gjatë klinike me produktet e tij. Prandaj, konsiderojmë të

pajustifikueshme kufizimin e ofertimit të teknologjive të reja, ekuivalente dhe në aspekte të caktuara më të avancuara, vetëm mbi bazën e përvojës së deklaruar me një prodhues tjetër.

**Provë**: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 30 tetor 2026

KUNDËRSHTIMET LIDHUR ME SPECIFIKIMET TEKNIKE

*Përsëritja e specifikimeve nga procedura e anuluar*

Siç u theksua më sipër, kundërshtimi i Ankuesit lidhur me specifikimet teknike është ngritur fillimisht në procedurën e mëparshme. Pas shqyrtimit të asaj kërkese,

Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar pjesërisht atë kërkesë dhe ka vendosur anulimin dhe rishpalljen e aktivitetit në fjalë. Megjithatë, në procedurën e re janë përsëritur parametrat që

Ankuesi kishte kundërshtuar si kufizues të konkurrencës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues i kishte pranuar si të tilla.

Theksojmë se vetëm rrishpallja e aktivitetit me numër tjetër prokurimi nuk e mënjanon problemin e ngritur, përderisa kërkesat teknike të kontestuara mbeten të njëjta.

Për këtë arsye, vendimi i mëparshëm dhe përsëritja e specifikimeve duhet të vlerësohen së bashku. Fakti që kërkesa e mëparshme është aprovuar pjesërisht nuk nënkupton se çdo pretendim

i saj është pranuar, por dëshmon se Autoriteti Kontraktues e kishte vlerësuar të nevojshme ndërhyrjen dhe rifillimin e procedurës.

Në këtë drejtim, Ankuesi kërkon që OSHP-ja të administrojë dosjet dhe anekset teknike të të dy aktiviteteve dhe të shqyrtojë përsëritjen e parametrave të identifikuar. Theksojmë

se ky krahasim duhet të bëhet ndërmjet specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në secilën procedurë, në lidhje me kundërshtimet dhe propozimet konkrete të Ankuesit.

Për Lotet 9 dhe 10, Ankuesi ka kërkuar heqjen e kriterit për programimin e pavarur të përshtatjes së frekuencës për dy zonat e aktivitetit fizik.

Kjo kërkesë është konkretizuar përmes tabelës së datës 27 tetor 2026, e cila nuk e përfshin këtë kriter. Për rrjedhojë, vendimmarrja duhej të përcaktonte nëse parametrat e propozuar për këto lote pranoheshin pa këtë kërkesë dhe ta pasqyronte këtë qëndrim në specifikimet përkatëse

***Për Lotet 11, 12, 13 dhe 14, kërkesa ka pasur për objekt largimin e alarmit zanor ose vibrues si kriter i detyrueshëm.***
***Kjo është përmbajtja konkrete e propozimit të paraqitur për shqyrtim. Duke qenë se njësia kërkuese është shprehur pozitivisht për***
***karakteristikat e paraqitura për këto lote, Autoriteti Kontraktues duhej të sqaronte nëse propozimi pranohej dhe çfarë efekti kishte ai mbi kriterin e kontestuar***

Për Lotet 12, 13 dhe 14, dallimi ndërmjet kërkesës së kontestuar dhe propozimit të Ankuesit është i shprehur qartë në dokumentacion: kriteri i kontestuar kërkon ATP para dhe gjatë ngarkimit, ndërsa propozimi përfshin ATP para ngarkimit. Prandaj, pranueshmëria e propozimit duhet të përcaktohet pikërisht në raport me këtë dallim. Një përgjigje pozitive që nuk pasqyrohet në vendimmarrje dhe në specifikimet e zbatueshme e lë të pazgjidhur çështjen për të cilën është kërkuar rishqyrtimi

***Për Lotin 12, kërkesa për heqjen e kriterit "Discrimination in VF Zone" është shoqëruar më pas me paraqitjen e një konfigurimi që përfshin së paku tre kritere***
***teknike dalluese për dallimin ndërmjet VT dhe SVT. Ky konfigurim i është paraqitur njësisë kërkuese për shqyrtim teknik dhe është riprodhuar në***

***Vendimin e Kontestuar. Kurse Ankuesi mbështetet në vlerësimin pozitiv të dhënë për karakteristikat e paraqitura dhe kërkon që pranueshmëria e këtij propozimi të përcaktohet shprehimisht në dokumentacionin e tenderit.***

Sa i përket kërkesës së Lotit 12 për "Possibility to program at least two options for sensing and pacing leads", vetë përgjigjja e datës 21 tetor 2026 ka lejuar shqyrtimin e

varianteve klinikisht ekuivalente me këtë funksion. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues duhej ta bënte të qartë mënyrën e zbatimit të këtij sqarimi, në lidhje me propozimin e

paraqitur më 27 tetor 2026 dhe me dispozitivin refuzues të Vendimit të Kontestuar.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues duhej të përcaktonte shprehimisht nëse ndryshimet e propozuara për Lotet 9–14 pranoheshin dhe si do të pasqyroheshin në Dosjen e Tenderit.

Megjithatë, ai e ka refuzuar kërkesën për përshtatjen e specifikimeve, ndonëse njësia kërkuese i ka vlerësuar pozitivisht karakteristikat e propozuara. Si pasojë, nga Vendimi nuk

kuptohet nëse gjatë vlerësimit të ofertave do të pranohen parametrat e propozuar nga Ankuesi apo do të kërkohet përmbushja e pandryshuar e kritereve të kontestuara.1.

Theksojmë se mospërputhja kryesore e Vendimit të Kontestuar rezulton nga vetë përmbajtja e tij. Në faqen 1, Autoriteti Kontraktues e refuzon kërkesën për rishqyrtim si të

pabazuar, ndërsa në faqen 7 përfshin një vlerësim pozitiv të njësisë kërkuese për karakteristikat e paraqitura për të gjashtë lotet.

4.1. Në përgjigjen e saj, njësia kërkuese i identifikon shprehimisht Lotet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 dhe deklaron se "karakteristikat e lartpërmendura janë klinikisht të arsyeshme,

beneficiale". Kjo përgjigje paraqitet direkt pas riprodhimit të kërkesës, përkatësisht tabelës së propozimeve të Ankuesit. Për rrjedhojë, ajo duhet të lexohet në lidhje me

parametrat konkretë që i janë paraqitur për shqyrtim Autoritetit Kontraktues.

*Më tej, njësia kërkuese deklaron shprehimisht: "[p]a dyshim, është e mundshme dhe e dobishme ofrimi i produkteve teknologjikisht*

*më të avancuara, të cilat ofrojnë karakteristika të njëjta apo më superiore, të cilat posedojnë certifikatat e*

*sigurisë dhe standartet e nevojshme, në përputhje me infrastrukturën e disponueshme në*

*shërbimin tonë.*

4.1. Ky qëndrim mbështet mundësinë e ofertimit të kërkuar nga Ankuesi, duke ruajtur kushtet e sigurisë, standardeve dhe përputhshmërisë. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues

nuk shpjegon pse, përballë këtij vlerësimi, kërkesa për përshtatjen e specifikimeve është konsideruar e pabazuar.

4.1. Në lidhje me këtë, referimi hyrës i njësisë kërkuese në "kërkesën fillestare dhe sqarimet e dhëna më vonë" nuk e zgjidh kundërthënien. Ky referim nuk përcakton

nëse propozimet konkrete pranohen sipas kërkesave ekzistuese, nëse kërkohet ndryshimi i tyre apo nëse ndonjë pjesë e propozimit nuk pranohet. Për më tepër, këto çështje

mbeten të paqarta edhe pas leximit të vendimit në tërësi.

Në të njëjtën linjë, deklarimi se karakteristikat i posedojnë shumica e prodhuesve më të mëdhenj të kësaj fushe nuk e sqaron

trajtimin e propozimeve të Ankuesit. Pasi që cështja që kërkonte zgjidhje ishte pranueshmëria e

parametrave konkretë të paraqitur për secilin

lot, përfshirë dallimet ndërmjet tyre dhe kritereve të kontestuara

Prandaj, mangësia e Vendimit qëndron te mungesa e një arsyetimi që e lidh vlerësimin pozitiv të njësisë kërkuese me përfundimin refuzues. Në lidhje me këtë, Autoriteti Kontraktues nuk

ka identifikuar në atë përgjigje ndonjë karakteristikë të propozuar si klinikisht të papranueshme dhe nuk ka paraqitur një arsye tjetër konkrete që shpjegon refuzimin e kërkesës për përshtatje

të specifikave teknike.

Kjo kundërthënie ka pasoja të drejtpërdrejta për përgatitjen e ofertës. Kjo pasi që Ankuesi duhet të përcaktojë produktet dhe dokumentacionin teknik mbi bazën e kërkesave të zbatueshme.

Ky i fundit nuk mund ta shpërfillë dispozitivin refuzues duke u mbështetur vetëm në përgjigjen pozitive të njësisë kërkuese dhe pranueshmëria e karakteristikave të propozuara nuk mund

të mbetet çështje interpretimi gjatë vlerësimit të ofertave.

Rrjedhimisht, Vendimi i Kontestuar nuk e përmbush detyrimin për arsyetim sipas Nenit 108/A të LPP-së dhe Nenit 62.2 të Rregullores për Prokurimin Publik, të lexuara

edhe në

dritën e standardit të Nenit 48 të LPPA-së. Për këtë arsye, kërkohet anulimi i tij dhe përcaktimi i qartë i pranueshmërisë së karakteristikave të propozuara, me pasqyrimin e këtij

përcaktimi në dokumentacionin e tenderit.

Nga sa u argumentua më sipër rezulton se
Autoriteti Kontraktues ka rishpallur tenderin me të njëjtat specifikime
teknike të kontestuara në procedurën e mëparshme të anuluar dhe e ka
refuzuar kërkesën e re për rishqyrtim, ndonëse njësia kërkuese i ka vlerësuar pozitivisht
karakteristikat e propozuara. Kjo kundërthënie e lë të paqartë pranueshmërinë e tyre gjatë vlerësimit të
ofertave dhe kërkon korrigjimin e
vendimmarrjes dhe të dokumentacionit
të tenderit

ologjikisht më të avancuara që përmbushin kërkesat klinike, të sigurisë dhe të përputhshmërisë. Rrjedhimisht, në mbështetje të Nenit 105, paragrafi 2, nënparagrafët 2.8, 2.10 dhe 2.11 të LPP-së, i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit të nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik AGS Corporation Sh.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me materiale shpenzuese për

ctrostimulim për nevojat e Kardiologjisë", me numër prokurimi 220-26-8424-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-26-088-1-1-1, për Lotet 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

**ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues, Shërbimit Spitalor dhe Klinik

Universitar të Kosovës, i datës 30 tetor 2026, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar,

hur me specifikimet teknike të Loteve 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

**OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë kërkesën e datës 27 tetor 2026 në përputhje me konstatimet e këtij Vendimi dhe me vlerësimin pozitiv të njësisë kërkuese dhe t'i

rigjojë specifikimet teknike për Lotet 9–14, duke përcaktuar shprehimisht parametrat e pranueshëm dhe mundësinë e ofertimit me zgjidhje ekuivalente ose teknologjikisht më të avancuara, me

jtjen e kërkesave klinike, të sigurisë, standardeve dhe përputhshmërisë me infrastrukturën e disponueshme.

**OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që ta informojë Organin Shqyrtues të Prokurimit për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Vendimi, brenda afatit të përcaktuar nga OSHP-ja.

**LEJOHET** kthimi i tarifës së Ankesës në shumën e paguar nga Operatori Ekonomik AGS Corporation Sh.P.K., në përputhje me Nenin 118, paragrafi 3, të LPP-së.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Përmes përcaktimit dhe ruajtjes së specifikimeve teknike kufizuese, si dhe mosqartësimit të pranueshmërisë së produkteve teknologjikisht ekuivalente ose më të avancuara, Autoriteti Kontraktues ka cenuar mundësinë e Parashtruesit të Ankesës për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe konkurruese në aktivitetin përkatës të prokurimit. Si rezultat, Ankuesi rrezikon të përjashtohet nga mundësia e ofertimit me produkte që mund të përmbushin kërkesat klinike dhe standardet e sigurisë, ose që oferta e tij të refuzohet për shkak të mospërputhjes me konfigurime të caktuara teknike, pa u shqyrtuar ekuivalenca funksionale e produkteve. Kjo i**

**shkakton ose rrezikon t'i shkaktojë Ankuesit dëm material përmes humbjes së mundësisë reale për konkurrim dhe përfitim ekonomik nga aktiviteti përkatës i prokurimit.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*